

## HYRJE

### 1. LEJA E QËNDRIMIT

- 1.1 Vizat
- 1.2 Leja e Qëndrimit
- 1.3 Karta e Qëndrimit
- 1.4 Bashkimi familjes
- 1.5 Kthim në kufi, Ndalim me forcë, Përjashtimi

### 2. REZIDENCA, LETËRNJOFTIMI, KODI FISKAL, PATENTA, AUTODEKLARATA, PËRKTHIM E LEGALIZIM DOKUMENTASH

- 2.1 Regjistrimi anagrafik, rezidenca
- 2.2 Etërnjoftimi
- 2.3 kodi fiskal
- 2.4 Patenta
- 2.5 Dokumentat e identifikimit
- 2.6 Autodeklarata
- 2.7 Përkthim e legalizim dokumentash

### 3. AZIL DHE REFUGJATË POLITIK, LEJA E QËNDRIMI PËR MOTIVE HUMANITARE

- 3.1 Azili dhe refugjatë politik
- 3.2 Leje e Qëndrimit për mbrojtje sociale

### 4. NËNSHTETËSIA

- 4.1 Marrja e nënshtetësisë automatikisht
- 4.2 Nënshtetësia e ligjëruar
- 4.3 Natyralizimi

### 5. PUNA

- 5.1 Punësimi për ata që kanë dokumenta të rregullta
- 5.2 Punësimi për ata që vijnë nga jashtë
- 5.3 Punë e pavarur - Kooperativa
- 5.4 Integritet ekonomike për ndihmesë: çeku familiar, pensioni, marrja e kontributeve të paguara në rast kthimi të përhershëm në atdhe

## **6. ASISTENCA SHËNDETSORE**

- 6.1 Regjistrimi në Shërbimin Shëndetsor Nacional
- 6.2 Nëna dhe fëmija
- 6.3 Kontraceptimi
- 6.4 Ndërprenja e shtatzanisë (abortimi)
- 6.5 Këshilltorja familjare për fëmijë
- 6.6 Rajonet shendetësore

## **7. ASISTENCA SOCIALE**

- 7.1 Qëndrat e shërbit social
- 7.2 Distrikti socio-shëndetsor
- 7.3 Shërbimet e distriktit

## **8. VËNDBANIMI DHE BANESA**

- 8.1 Banesat me qera
- 8.2 Banesat sociale
- 8.3 Ndhme ekonomike për pagesën e qerasë
- 8.4 Qendrat për banim të përkohshëm - case albergo
- 8.5 Blerja e shtëpisë

## **9. SHKOLLA DHE UNIVERSITETI**

- 9.1 Regjistrimi shkollor
- 9.2 Çerdhja për fëmijët
- 9.3 Kopshti për fëmijët
- 9.4 Shkolla elementare
- 9.5 Shkolla e mesme e ulet
- 9.6 Shkolla e mesme e ciklit të lartë
- 9.7 Universiteti
- 9.8 Shkollimi i të rriturve
- 9.9 Njohja e studimeve të bëra jashtë
- 9.10 Njohja e profesioneve
- 9.11 Veçantija e profesioneve sanitare

## **10. SHKOLLA PROFESIONALE**

- 10.1 Llojet e formimit
- 10.2 Shërbimi i konsulencës mbi formimin profesional

## **11. MBROJTJA E TË DREJTAVE**

- 11.1 E drejta e mbrojtjes
- 11.2 Gratuito patrocinio
- 11.3 Mbrojtësi qytetar “Difensore civico”
- 11.4 Norma ligjore për fëmijët
- 11.5 Masa kundër diskriminimit rracial

## **12. KULTURA DHE BASHKËPUNIMI INTERETNIK**

- 12.1 Qendra për zhvillimin kulturor
- 12.2 Bashkëjetesa interetnike
- 12.3 Bashkëpunimi për zhvillim

## 1.

## LEJA E QËNDRIMIT

### 1.1 VIZAT:

Hyrja në territorin e Shtetit italian i lejohet të huajve, të paisur me pashaportë të vlefshme ose me një dokument ekuivalent; në shumicën e rasteve, (me përjashtim të disa shtetasve), bashkë me vizën e hyrjes të dhënë nga Ambasada italiane në Shtetin e origjinës ose të rezidencës normale.

Vizat e hyrjes konsiderohen: afatshkurtër n.q.s. zgjasin jo më shumë se 90 ditë dhe afatgjata, ato viza që zgjasim mbi 90 ditë, për të cilat i lëshohet përkatësit së vizës një Leje Qëndrimi (Permesso di soggiorno) në Itali me të njëjtin motiv që përmbahet tek viza.

### 1.2 LEJA E QËNDRIMIT (PERMESSO DI SOGGIORNO):

#### SI MERRET?

Leja e qëndrimit i kërkohet Kuestorit të provincës, në të cilën shtetasi i huaj mendon të qëndrojë, brënda 8 ditëve pune \* (duke mos numëruar ditët e pushimit ose të festave) nga data e hyrjes së tij në territorin e Shtetit italian; në mungesë të kërkesës brënda këtij afati të caktuar provokohet përjashtimi prej territorit të Shtetit. Shtetasit të huaj që kërkon L.Q. do i merren shenjat e gishtave.

**Rinovimi i L.Q. duhet të kërkohet të paktën 90 ditë para skadancës në lidhje me një punë si vartës me kohë të pacaktuar, të paktën 60 ditë përpara skadancës në lidhje me një punë si vartës me kohë të pacaktuar, të paktën 30 ditë përpara skadencës në rastet e tjera. Shtetasit të huaj që kërkon L.Q. do i merren shenjat e gishtave.** Mos kërkimi i rinovimit të dokumentave provokon vendimin e Prefektit për përjashtim nga territori i Shtetit n.q.s. kanë kaluar më shumë se 60 ditë nga afati i skadimit.

Shtetasit e huaj me dokumenta të rregullta kanë të drejtë të regjistrohen në Zyrat e gjëndjes civile të Komunës në të cilën duan të qëndrojnë. **Brënda 60 ditëve pasi keni rinovuar Lejen e qëndrimit është e domosdoshme të rinovohet deklarata e banesës në Komunën ku banon,** duke paraqitur Lejen e qëndrimit të rinovuar tek Zyra e Gjëndjes civile (Anagrafe).

#### LEJE QËNDRIMI PËR PUNË SI VARTËS

#### PËR CILIN?

Leja e qëndrimit për punë si vartës i jepet:

- kujt vjen në Itali me autorizim për punë i thirrur direkt nga punëdhënsi, nëpërmjet një kërkesë paraqitur tek Drejtoria Provinciale e Punës. (vit për vit vendoset numri i shtetasve të huaj të cilët mund të hyjnë në Itali për punë), domethënë nëpërmjet firmosjes së një kontrate qëndrimi për punë si vartës midis një punëdhënësi italian ose të huaj dhe punëtorit të huaj, me anë të së cilës punëdhënësi impenjohet të garantojë disponueshmërinë e një banese për punëtorin dhe pagimin e shpenzimeve të udhëtimit për kthimin e punëtorit të huaj në vendin e tij.

- Me vizën për punë si vartës, brënda 8 ditëve punë, paraqitesh në Kuesturë bashkë me komunikimin e fillimit të punës, deklarohet banesa dhe dorëzohen 4 fotografi për dokumenta bashkë me një pull takse “marca da bollo” prej 10,33 €;

**Rinovimi për ata që kanë Leje qëndrimi për punë o pritje pune dhe aktualisht punon.**

### **ÇFARË DOKUMENTASH DUHET TË PARAQITEN NË KUESTURË?**

- L.Q. origjinale
- Kopja e kontratës së punës
- Kopja e komunikimit të punëdhënsit bërë të zyra e punës.
- Fotokopjen e librezës së punës ose ekstrakt të pozicionit të punës
- Disponueshmeria e një banese
- Fotokopja e pashaportës
- 5 fotografi
- pull takse “marca da bollo” prej 10,33 €

**SHËNIM:** duhet të kini me vete gjithnjë pashaportën origjinale!

**Rinovimi për ata që kanë Leje qëndrimi për punë dhe aktualisht nuk punojnë.**

### **ÇFARË DOKUMENTASH DUHET TË PARAQITEN NË KUESTURË?**

- L.Q. origjinale
- Fotokopja e librezës së punës
- Deklarata për të ardhurat e vitit të mëparshëm ose buste paghe te vitit te meparshem ose prova te tjera qe tregojne te ardhura te ligjshme me te cilat jetohet
- Fotokopja e pashaportës
- Disponueshmeria e banesës
- 5 fotografi
- pull takse “marca da bollo” prej 10,33 €

**SHËNIM:** duhet të kini me vete gjithnjë pashaportën origjinale!

Mund të merrni një Leje qëndrimi për “pune ne pritje te punes” që **zgjat 6 muaj** prej afatit të punës së fundit që keni kryer. **Kjo lloj L.Q. nuk rinovohet një herë të dytë nëse në momentin e skadimit nuk keni gjetur akoma një punë e nuk keni punuar gjete kohes kur ajo ishte e vlefshme.** Pra:

#### **VINI RE!**

Sapo gjeni punë, të ndërroni menjëherë motivin e Lejes së qëndrimit (permesso për lavoro) duke paraqitur kontratën e punës në Kuesturë

Kush mbetet i papune për me shumë se 6 muaj rrezikon refuzimin e L.Q. dhe duhet të largohet nga Italia sipas ligjit.

L.Q. për “attesa occupazione” nuk mund të rinovohet përsëri me të njëjtin motiv. Për informacione të mëtejshme jeni të lutur të kontaktoni zyrat e konsultimit ne kohe.

## LEJE QËNDRIMI PËR TURIZËM.

N.q.s. dëshironi të ftoni dikë, atëherë personi të cilin ftoni duhet të bëjë një kërkesë për vizë turistike.

### KU?

Në Ambasadën Italiane në Shqipëri.

### ÇFARË DOKUMENTASH DUHEN PARAQITUR?

- pashaportën;
- një deklaratë - ftesë i nje personi banues i rregullt ne Itali,me të cilën impenjohet të presë personin që kërkon vize ne shtëpinë e tij.
- Bileta e udhëtimit ose prenotimi vajtje-ardhje.
- Të ardhura për mjetet e qëndrimit, në bazë të afatgjatjes së vizës (maksimumi 90 ditë) (për 30 ditë duhen rreth 1.033 €). Duhet dërguar në Ambasadë një depozitim bankar i bërë nga personi që pret, për mikun e ftuar, në një banke italiane.

Në momentin e kërkesës së vizës nuk është i domosdoshëm një polizza assicurativa për **sigurimin shëndetsor**. Kërkohe vetëm për ata persona që qëndrojnë me shumë se 30 ditë kur bëjnë kërkesën e L.Q "për turizëm" në Kuesturë , që kërkohe brenda 8 diteve nga hyrja ne Itali .

## 1.3 KARTA E QËNDRIMIT (CARTA DI SOGGIORNO)

Është leja e qëndrimit pa afat të përcaktuar; një element mjaft i rëndësishëm për integrimin në shoqëri.

### KUSH?

Kanë të drejtë qytetarët e huaj të cilët kanë një leje qëndrimi të rinovueshme (punë, azil politik, familje)

### Kushtet:

- 6 vjet rezidencë në Itali (fotokopjen e L.Q.)
- Çertifikatë rezidence ose autodeklaratë për rezidencën aktuale.
- Auto deklaratë per residenzën aktuale
- Auto deklaratë për vëndet e banimit gjatë 6 viteve të fundit.
- Fotokopja e pashaportës
- Deklarata e të ardhurave për vitin e shkuar ku të figurojnë të paktën 4.556 €
- Deklaratë pune dhe 3 busta pagat e fundit
- Çertifikatë nga Gjykata (Tribunale)
- Çertifikatë për dënime penale nga Gjykata (Tribunale)
- 5 fotografi
- Pull takse "marca da bollo" prej 10,33 €

### KU?

Kërkohe në **Kuesturën** e rezidencës. Në Bolzano tek Via Marconi 33.

**N.q.s. kërkohet dhe për familjarët** (bashkëshortin dhe fëmijet në ngarkim) atëherë duhet të paraqiten edhe dokumentat që vijojnë:

- Deklaratë për një banesë të përshtatshme (mund të jetë me qera, i strehuar nga miq, shtëpi e vetja) me certifikatë di "idoneità alloggiativi në Bolzano pranë Zyrës comunale të Piazza Don Bosco.
- Të ardhurat vjetore janë të njëjtat me ato që kërkohen për bashkim familje..
- Certifikatë të përkthyer nga shqipja që vërtetojnë lidhjen e martesës dhe atësinë e fëmijëve (nëse bashkëshorti dhe fëmijët janë të shkruajtur në L.Q. atëherë nuk është e nevojshme kjo certifikatë)

Për familjarët të cilët i bashkangjiten kryefamiljarit në kërkesën e Kartës së qëndrimit, nuk janë të domosdoshme 6 vitet e rezidencës. Dhënia e kartës mund të refuzohet nëse emigranti është dënuar për akte të paligjshme. Hiqet e drejta për kartën vetëm në rastet e dënimit për nenet 380 e 381 të Kodit të Procedurës Penale.

Kundër refuzimit të kartës mund të bëhet apel tek TAR-i (Gjykata Administrative Rajonale).

### TË DREJTAT QË FITOHEN ME KARTËN E QËNDRIMIT

Karta e qëndrimit është me **afat të pacaktuar** dhe si dokument **vlen 10 vjet**, 5 vjet si dokument identifikimi.

#### PËRSE?

- Nuk duhet më të shqetësohesh për rinovimin çdo 1 – 2 vjet.
- Shumë ndihma sociale (pension invaliditeti civil, ndihmë për leje lindje e të tjera) i garantojnë vetëm të huajve që kanë Kartën e qëndrimit.
- Kush ka Kartën nuk mund të përjashtohet nga territori i shtetit (vetëm për motive të rënda lidhur me sigurinë publike ose krime të rënda).

## 1.4 BASHKIMI I FAMILJES (RICONGIUNGIMENTO FAMILIARE)

### KUSH?

Kush bën kërkesën për bashkim familje:

- Të huajt që kanë Kartën e Qëndrimit
- Të huajt që kanë Leje Qëndrimi me afat më tepër se 1 vit (për punë si vartës ose i pavarur, për azil politik, për studime e për motive fetare)

Në favor të kujt:

- Bashkshortit
- Bijve të cilët janë nën 18 vjeç
- Bijve mbi 18 vjeç nëse janë invalid
- Prindërve në ngarkim, kur nuk kanë fëmijë të tjerë në vendin e origjinës, ose në rast se prindërit kanë më tepër se 65 vjeç e fëmijët e tjerë nuk janë në gjendje të mbajnë për motive shëndeti të dokumentuara.

**KU?**

Kërkesa bëhet në sportelin e vetëm për imigrimin pranë Kuesturës së vëndit ku jeni rezident, në Bolzano të rruga Marconi 33.

**SI?**

Kërkuesi duhet të plotësojë këto kushte:

- Të ketë një banesë në përdorim, me qera ose si pronë të vetën, (paraqiten dokumentat relative për shtëpinë si kontrata e qerasë). Duhet të paraqisni një çertifikatë për banueshmërinë dhe përmasat e apartamentit nga Zyra Teknike e Komunës “Ufficio Tecnico del Comune” ose Ndërmarrjes shëndetsore “A.S.L.”. Në Bolzano matja e apartamentit kërkohet tek “Ufficio Tecnico comunale” në Piazza Don Bosco 15.
- Masat e shtëpisë janë të tilla: 23 m<sup>2</sup> për kërkuesin + 15 për vetën e parë e + 10 metra për çdo person tjetër. (aktualisht Kuestura e Bolzanos nuk llogarit fëmijët nën moshën 14 vjeç për metraturen e shtëpisë).
- Të ketë të ardhura vjetore baraz me assegno sociale (për 2002 4.556,00 €) nëse kërkesa bëhet vetëm për një familiar, dyfishi nëse kërkesa bëhet për 2 ose 3 familiarë, trefishi nëse bëhet për 4 ose më shumë familiarë.
- Deklaratën mbi të ardhurat e vitit të kaluar (cud-Unico-730), gjithashtu rrogën e fundit për të demonstruar të ardhurat e përkohshme.
- Fotokopie të pashaportës dhe pull takse “marca da bollo” prej 10,33 €.
- Dokumentat që vërtetojnë raportet e farefisnisë, martesës, dhe të moshës nën 18 vjeç të vërtetuara nga ambasada italiane.

Kuestura brënda 90 ditëve jep përgjigjen. Me “Nulla osta” familiar/ët paraqiten në ambasadë për të marrë vizat, nëse prindi duhet të vërtetojë që është në ngarkim duhet të paraqiten fotokopiet e shumave të hedhura në bankë në emër të prindit nga i biri, gjatë muajve të mëparshëm. Kur mbërrijnë në Itali me vizë për bashkim familje “ricongiungimento familiare” brënda 8 ditëve duhet të paraqiten në Kuesturë (Rajonin e Policisë) për të bërë Lejen e Qëndrimit për motive familiare me të cilën mund të punohet ose të studjohet.

Nqs. Kuestura jua refuzon kërkesën dhe nuk lëshon “Nulla osta” për familiarët mund të drejtoheni në Gjykatë për apel.

## 1.5 KTHIMI NË KUFË, NDALIMI DHE PËRJASHTIMI NGA SHTETI

### KTHIMI NË KUFË

#### KUSH?

I kthejnë prapa të huajt që paraqiten në postobloqet kufitare pa dokumenta të cilat autorizojnë shkëljen e territorit italian. Poashtu kthehen mbrapa të gjithë të huajt që:

- Hyjnë në Itali pa kontroll duke ju fshehur kontrolleve kufitare.
- Nuk janë të paisur me dokumente që lejojnë hyrjen në territorin e Shtetit italian, qoftë se përkohesisht lejohet prania e tyre për motive humanitare.



### Ndalohet përjashtimi për:

- KUSH kërkon azil politik.
- KUSH ka statusin e refugjatit politik.
- KUSH gëzon të drejtën e mbrojtjes për motive humanitare.
- Fëmijët nën 18 vjeç

### NDALIM ME FORCË

Dekretohet nga Kuestori në një kamp të përkohshëm **centro di permanenza temporanea** kur nuk është i mundur ekzekutimi i menjëhershëm i përjashtimit nga gjykata. Konvalidimi sjell si konsekuencë qëndrimin (me force) në një kamp për një periudhë 30 ditore e zgjatshme edhe 30 ditë të tjera.

Kur kanë kaluar ditët e qëndrimit pa qenë e mundur të kryhet përjashtimi nga shteti, kuestori i urdheron të huajt , me një masë të shkruar, të largohet nga territori i shtetit brenda 5 diteve. I huaji që vazhdon të qëndrojë për më tepër se 5 ditë, pa motiv të justifikuar, ndëshkohet me arrestim nga 6 muaj deri në një vit e largohet nga shteti me shoqërimin në kufi nga forcat e rendit. I huaji i përjashtuar e i gjetur përsëri në territorin e shtetit ndëshkohet me burgim nga një deri në katër vjet. Në të dy rastet parashikohet arrestimi i detyruar dhe procesi me rrugë të shkurtër.

### PËRJASHTIMI

Përjashtimet përfaqësojnë fakte të rënda e janë menjëherë ekzekutive nqs. Ju ndodh ose keni frike se mund tju ndodh duhet të **drejtoheni menjehere në zyrat për konsulence ligjore (të një avokat).**

### TIPET E PËRJASHTIMIT

#### 1. Përjashtim administrativ

- Me dekret (kompetencë) e Ministrit të Brëndshëm.
- Me dekret të Prefektit (për Provincën e Bolzanos është kompetencë e Kuestorit).

#### 2. Përjashtim gjygsor

- Me urdhër të gjykatësit penal si masë sigurie.
- Me urdhër të gjykatësit penal, si sanksion zëvendësues për dënime me burgim jo më tepër se për 2 vjet për një të huaj jo të rregullt , pa dokumenta.
- Me urdhër të gjykatësit mbikëqyrës, si snksion alternativ per të huajin pa dokumenta,në burg me një dënim definitiv, që duhet të përfundoj dënimin edhe deri në dy vjet.

## PËRJASHTIMI ADMINISTRATIV

Autoriteti që vepron	Motivi	Mënyra	Apeli
Ministria e punëve të brendshme	Siguria shtetërore	Me shoqërim në kufi	Tar Lazio
Prefekti /Kuestori	Shkelje e ligjit për hyrjen në territorin e Shtetit italian.	Urdhër për tu larguar brenda 15 ditëve vetë m për kë ka L.Q. të skaduar prej më shumë se 60 ditësh e nuk ka kërkuar rinovimin <ul style="list-style-type: none"> <li>Në të gjitha rastet e tjera shoqërim i menjëhershëm në kufi përveç mundësisë së mbajtjes në centri di permanenza (kampe) te përkohshme deri në 60 ditë se nuk është e mundur përjashtimi i menjëhershëm</li> <li>Kur nuk është i mundur shoqërimi i menjëhershëm e nuk është i mundur mbajtja në kamp ,merret një urdhër i kuestorit për tu largura nga Italia brenda 5 diteve. Shkelja e këtij urdhëri sjell arrestimin</li> </ul>	Gjykata ordinere, 10 ditë brenda Urdhëresës.
Prefekti /Kuestori	Qytetar i huaj për të cilin ka dyshime që zhvillon aktivitete të paligjshme.	Shoqërim në kufi përveç qëndrimit në kamp kur nuk dihet identiteti	Gjykata ordinere, 60 ditë brenda Urdhëresës.

### SI?

Dekreti i përjashtimit duhet të jetë me shkrim dhe të përmbajë motivin e përjashtimit bashkë me mënyrën e apelit. Nëse i huaji nuk kupton gjuhën italiane, atëherë dekreti i përjashtimit duhet të jetë i përkthyer shkurtimisht në një gjuhë të cilën e kupton, se kjo nuk është e mundur në anglisht, frëngjisht o spanjisht, sipas preferencës së të interesuarit. I huaji duhet të jetë i informuar edhe mbi të drejtën për të marrë një avokat mbrojtës.

Efektet e dekretit të përjashtimit nga territori:

- Detyrim, për qytetarin e huaj dhe bijtë e tij në ngarkim, që të largohen nga territori i Shtetit italian;
- Ndalohet hyrja legale në Itali përgjithësisht për 10 vjet, megjithatë jo më pak se 5 vjet nga data e daljes efektive të qytetarit të huaj të përjashtuar;
- Sinjalizim i të dhënave personale të personit që përjashtohet tek S.I.S. (Sistemi Informativ Schengen).

### APELIMI

Mund të bëhet apelimi kundër dekretit të përjashtimit tek Gjykata e përgjithshme brenda 60 ditëve nga komunikimi me shkrim edhe nëpërmjet ambasades italiane në Tiranë.

## KU?

Apeli duhet të bëhet pranë Gjykatës së vëndit ku ndodhet autoriteti i cili shkruan dekretin e përjashtimit.

## TË HUAJT QË NUK MUND TË PËRJASHTOHEN:

Ligji parashikon disa kategori personash të cilët nuk mund të përjashtohen nga territori dhe marrin një Leje Qëndrimi të përkohshme ose të përhershme, sipas tipologjisë përkatëse:

Kategoria	Leja e Qëndrimit që lëshohet
Fëmijët e huaj nën moshën 18 vjeç	Leje Qëndrimi për "minore età" nëse nuk janë të shoqëruar nga prindër ose kujdestare (kjo lloj leje skadon dhe nuk rinovohet kur mbushen 18 vjeç) Leje Qëndrimi për Familje (e rinovushme) nëse ka një prind me dokumenta. Leje qendrimi për affidamento bazuar tek treguesit e komitetit për minoret (nën 18 vjeç) e huaj që të mos kryhet riatëdhësimi o në rast besimi/affidamento nga ana e gjykatës së minoreve.
Të huajt të cilët kanë Kartën e Qëndrimit ( janë të përjashtueshëm vetëm për motive të rënda të rendit publik e sigurimit shtetëror)	Në se tërhiqet Kartën e Qëndrimit (nëse merret një denim parashikuar nga nenet 380 e 381 të Kodit për procedurën penale)mund të merret një L.Q. e re për motiv tjetër p.sh.për punë
Të huaj që bashketojnë me të afërm (ose bashkshort) të cilët janë qytetar italian	Leje Qëndrimi për motive familiare (mund të kërkohet edhe karta e qëndrimit se bashkeshort, fëmij o prind.)
Gratë shtatzanë e në gjashtë muajt që pasojnë lindjen.	Leje Qëndrimi për kura mjeksore e cila vlen deri në fund të muajit të 6-të pas lindjes së fëmijës (mund të bëhet kërkesa edhe për bashkeshortin bashkëjetues nëse edhe ai është pa dokumenta).

# 2.

## REZIDENCA, LETËRNJOFTIMI, KODI FISKAL, PATENTA, AUTODEKLARATA, PËRKTHIM E LEGALIZIM DOKUMENTASH.

### 2.1 REGJISTRIMI ANAGRAFIK DHE REZIDENCA

#### SI?

Bëhet me të njëjtat kushte që kanë dhe qytetarët italianë, duke plotësuar një modular pranë Zyrës së gjëndjes civile, në të cilin shkruhen të dhënat personale, vëndi i ardhjes dhe adresa e banimit ku kërkohet rezidenca. Duhet të paraqitet edhe Leja e Qëndrimit bashkë me pashaportën origjinale. Nënpunësi i gjëndjes civile do të bëjë verifikimet e duhura për të vërtetuar banimin efektiv në vëndin që keni deklaruar tek modulari.

Mbas regjistrimit anagrafik mund të kërkoni çdo lloj dokumenti që lëshon Zyra Anagrafike (stato di famiglia, residenza etj.). është gjithashtu e mundur të kërkoni paisjen me Letërnjoftim “Carta d’identità” (e cila nuk ka vlerë jashtë shtetit) që shërben për të shfrytëzuar të gjitha shërbimet sociale të ofruara nga Bashkia. **Regjistrimi anagrafik** është kusht i domosdoshëm për lëshimin e patentës për të ngarë mjete automobilistike.

Regjistrimi anagrafik duhet të **rinovohet** brënda 60 ditëve pasi rinovoni Lejen e Qëndrimit, duke ja paraqitur këtë të fundit të rinovuar.

Nëse kalon më shunë se 1 vit nga rinovimi i Lejes së Qëndrimit dhe nuk bëhet rinovimi i regjistrimit anagrafik, ligji parashikon fshirjen e emrit nga lista e rezidentëve. Ky vendim anulohet nëse regjistrimi bëhet sërish gjatë 30 ditëve që pasojnë.

Nëse ndërroni banesë duhet të komunikoni ndërrimin tek Zyra Anagrafike. Fshirja nga listat e rezidentëve dhe ndryshimi i banesës i komunikohen Kuesturës nga ana e Zyrës Anagrafike brënda 15 ditëve.

### 2.2 ETËRNJOFTIMI “CARTA DI IDENTITÀ”:

#### PËR KË?

Për të gjithë ata që kanë marrë rezidencën me anë të regjistrimit anagrafik.

#### PËRSE DUHET?

Vërteton identitetin e personit dhe vlen për 5 vjet.

#### KU MERRET?

Kërkohet tek Zyra Anagrafike “Ufficio Anagrafe” në të cilën keni bërë regjistrimin anagrafik.

### 2.3 KODI FISKAL “CODICE FISCALE”

#### PËR KË?

Duhet ta kenë të gjithë ata që banojnë në Itali.

## PËRSE SHËRBEN?

Përbëhet nga një seri numrash dhe gërmash me të cilat identifikohet personi dhe karakterizojnë individin për veprimet fiskale, dokumente pune e për të paguar taksat.

## KU?

Kërkohet pranë “Ufficio Provinciale delle Imposte dirette” me pashaportën dhe Lejen e Qëndrimit.

## 2.4 PATENTA “PATENTE DI GUIDA”

### PËR KË?

Është dëshmi aftësie për të ngarë automjetet dhe motoçikletat.

### SI MERRET?

Me anë të një provimi i përbërë nga teoria dhe praktika.

### KU?

Për informacione drejtoheni tek zyrat e ACI-it ose tek Autoshkollat private.

**Patenta ndërkombëtare** ka vlefshmëri vetëm për 1 vit rezidencë në Itali.

## 2.5 DOKUMENTAT E IDENTIFIKIMIT

Në Itali, letër njoftimi, Leja ose Karta e Qëndrimit, pashaporta, dhe patenta duhen paraqitur nëse kërkohen nga funksionerët e policisë, karabinierët, guardia di finanza dhe Vigili Urbani (policia qytetare). Në rast rinovimi i tregohet edhe riçevuta e Kuesturës.

## 2.6 AUTODEKLARATA

Një sërë dokumentash mund të zëvendësohen me anë të një deklaratë e lëshuar nga vetë personi i intresuar nën përgjegjësinë vetiake duke plotësuar module të përgatitura nga zyrat publike.

## 2.7 PËRKTHIM E LEGALIZIM DOKUMENTASH

### PËR KË?

Në rastet kur dokumentet duhen përkthyer nga shqipja në italisht.

### KU?

- duhet t'i drejtoheni Ambasadës italiane në vëndlindje.
- Nëse dokumenti ndodhet në Itali, drejtoheni tek Shoqata e Ndërmjetësve Kulturorë të kualifikuar **Porte Aperte-Offene Türen** Via Portici 49 Bolzano ose tek listat e përkthyesve në Gjykatë.

## 3.

## AZIL DHE REFUGJATË POLITIK, LEJE QËNDRIMI PËR MOTIVE HUMANITARE.

### 3.1 AZIL DHE REFUGJATË POLITIK

Atyre që bëjnë kërkesën për azil politik u lejoheq qëndrimi në Itali deri në momentin e aprovimit/shqyrtimit të kërkesës.

#### KU BËHET?

- Direkt tek policia kufitare;
- Pranë Kuesturës;
- Në Bolzano mund të drejtoheni pranë zyrës “Flüchtlingsberatung Caritas Consulenza Profughi”, Caritas sezione tedesca, Rruga Marconi 7.

#### SI BËHET?

Kërkesa nuk pranohet nëse:

- Është bërë një kërkesë e mëparshme në një shtet tjetër.
- Nëse keni Leje Qëndrimi në një shtet pjesmarrës në Paktin e Gjenevës;
- Nëse keni pësuar dënim në Itali në bazë të paragrafit 1 dhe 2 të nenit 380 Kodi i procedurës penale si individ i rrezikshëm për sigurinë shtetërore ose pjesmarrës në organizata mafioze, terroriste ose që merren me trafik droge.

Në rastet e mësipërme të kthejnë prapsh në kufi. Pranohet apeli ,në rast kthimi pa të drejtë, në Gjykatë.

#### Pranimi i kërkesës për azil.

Sapo merret kërkesa për njohjen e statusit të refugjatit, kuestori kompetent për vendin ku bëhet kërkesa, bën të mundur qëndrimin e të huajt në qendrën e identifikimit.

Brenda 2 DITEVE nga marrja e kërkesës , kuestori i trazmeton dokumentat e nevojshme ,komisionit territorial për njohjen e statusit të refugjatit, që brenda 15 DITEVE nga marrja e dokumentave, bën të mundur dëgjimin e të interesuarit. Vendimi merret në 3 DITET që pasojnë. Kuestori deri sa mbaron kjo procedurë lëshon një L.Q. të përkohëshme se i kërkohet.

#### Të drejtat e atyre që kërkojnë azil:

- Asistencë shëndetsore;
- Kurse gjuhe italiane falas, aty ku mbahen
- E drejta e shkollimit, me detyrim për fëmijët;
- Mundësi strehimi në një strukturë publike për strehimin e parë.;
- **Kontribut ekonomik për asistencë** për ata që nuk kanë të ardhura.

**Komisioni territorial** merr në shqyrtim kërkesën me:

- Dëgjim personal, “kur kërkohet statusi nga i interesuari” , e ka mundësi të shprehet në gjuhën e vet me presencën e përkthyesit.
- Vendime në mënyrë kolektive
- Detyrim që të motivohet vendimi

Vendimet e komisionit territorial mund të jenë:

- Njohja e statusit të refugjatit
- Refuzimi i njohjes së statusit
- Refuzimi i njohjes së statusit me rekomandim “kur ka motive serioze në veçanti të karakterit humanitar”, me referim art. 5 të dekretit legjislativ n. 286/98 i Testit të vetëm mbi imigrimin, kuestura lëshon një **leje qëndrimi** për motive **humanitare**, e vlefshme për një vit, me autorizim për punë e studime.

### **Kërkesa për riekzaminim dhe e drejta për apel.**

Në rast refuzimi mund të kërkohet brenda 10 DITEVE **rishqyrtimi** i vendimeve me një kërkesë të motivuar në mënyrë të përshtatshme, nga ana e të interesuarit , i cili vazhdon të qëndrojë në qendren e identifikimit.

Kërkesë i prezantohet komisionit territorial brenda 5 DITEVE nga komunikimi i vendimit.

**Apeli** i mundshëm kundër vendimit të komisionit territorial prezantohet tek gjykata kompetente për territor brenda 15 DITEVE edhe nga jashtë nëpërmjet përfaqësuesve diplomatik.

Apeli nuk pezullon vendimin për largimin nga territori i shtetit ; kërkuesi i strehimit megjithatë mund të kërkojë prefektit kompetent që të qëndrojë në territorin e shtetit deri në arritjen e përgjigjes së apelit. Vendimi i apelit është menjëherë ekzekutiv.

## **3.2 LEJE QËNDRIMI PËR MOTIVE TË MBROJTJES SOCIALE**

Kjo Leje Qëndrimi i jepet të huajit i cili ndodhet nën kërcënimin ose dhunën të ushtruar mbi të ose rafugjatitshfrytëzim njerëzor me qëllim të dalë nga kjo situatë e cila sjell rrezik për personin.

### **SI?**

Kërkesa bëhet nga:

- **Shërbimi social** ose **shoqata dhe organizata** të regjistruara në Dapartamentin e Punëve Sociale;
- Prokuratori i Republikës, në rastet kur fillohet një proces penal.

### **KU?**

Kuestura verifikon kushtet dhe lëshon një **Leje Qëndrimi** për  **motive humanitare** me afat 6 mujor e cila mund të rinovohet për 1 vit tjetër dhe mund të kthehet në Leje Qëndrimi për punë ose studim.

## 4.

## NËNSHTETËSIA

## 4.1 MARRJA E NËNSHTETËSISË AUTOMATIKISHT SI MERRET?

- **Kur lind** nga një prind shtetas italian;
- **Tranzicion me të drejtë**, shtetasi i huaj i cili merr nënshtetësinë italiane ia kalon bijve të tijë nën moshën 18 vjeç, që kur mbushin të tetëmbëdhjetat mund të heqin dorë për të ruajtur nënshtetësinë e mëparshme.

## 4.2 NËNSHTETËSIA E LIGJËRUAR

Vlen për qytetarët e huaj të cilët rrjedhin nga prindër ose të afërm të grasës së dytë (gjyshërit), shtetas italian, mund të marrë nënshtetësinë me anë të një deklarate nëse:

- kryen shërbimin ushtarak në Itali;
- punësohet në një vënd publik, si nënpunës shtetëror.
- nëse kur mbush 18 vjeç ka të paktën 2 vjet rezidencë në Itali.

Qytetari i huaj i cili ka lindur në Itali, mund të bëhet shtetas italian nëse ka jetuar vazhdimisht pa shkëputur rezidencën nga Italia e kur mbush të tetëmbëdhjetat shpreh me vullnet të lirë dëshirën për të marrë nënshtetësinë italiane.

## 4.3 NATYRALIZIMI

Natyralizimi është dhënia e nënshtetësisë me anë të një vendimi shtetëror administrativ që merret në këto raste:

**Pas martesës me një shtetas italian:**

**SI?**

Duhet të paktën 6 muaj rezidencë në Itali pas martesës ose 3 vjet martese efektive nëse ndodheni jashtë Italisë.

**KU?**

Prefektura (për Provincën e Bolzanos kërkohet tek "Commissariato del governo") (pranë Ambasadës ose konsullatës italiane nëse ndodheni jashtë Italisë)

Ministria e Brëndshme: duhet të lëshojë dekretin e nënshtetësisë brënda 2 vjeteve. Nëse nuk e jep brënda këtij afati, atëherë i ineresuari mund të drejtohet pranë një gjykatësi, i cili deklaron me anë të një vendimi të drejtën për nënshtetësinë italiane.

Për natyralizim ordiner, i jepet qytetarit/ës të huaj jo shtetas i Komunitetit Europian nëse:

- Bën kërkesën pas 10 vjetëve rezidencë të rregullt në Itali;
- Ka patur gjatë gjithë 10-vjeçarit dokumenta të rregullta për qëndrim në Itali;
- Banon efektivisht dhe rregullisht në Itali.



Kërkesa për të marrë nënshtetësinë duhet t'i paraqitet tek Komisarri Qeveritar "Commissariato del Governo".

### Lista e dokumentave të cilat duhen paraqitur pranë zyrës së "Commissariato del Governo" për natyralizimin pas 10 vitesh rezidencë:

#### a. Dokumentet nga Vëndi i lindjes:

- çertifikatë lindje me të dhënat e plota (emri dhe mbiemëri i të dy prindërve) e përkthyer, e autentikuar dhe e legalizuar në ambasadën italiane;
- çertifikatë penale nga shteti i origjinës e përkthyer, e autentikuar dhe e legalizuar në ambasadën italiane.

#### b. Dokumentatë cilat mund të merren në Itali ose bëhet autodeklaratë:

- rezidenca historike e 10 viteve të fundit në Itali, duke shënuar të gjitha vëndet ku keni banuar (qytet e adresë);
- çertifikata e gjëndjes familiare, prej sa personash përbëhet familja këtu në Itali;
- çertifikatë penalena Gjykata italiane;
- deklarata mbi të ardhurat e tre viteve të fundit: minimalaja e parashikuar është 8.263,31 € në vit nëse kërkuesi është një person, për bashkshortin duhen edhe 3.098,74 € më shumë, për çdo fëmijë + 517 € të tjera;
- autorizim nga Shteti përkatës i origjinës për të dhënë të gjitha të dhënat e nevojshme autoriteteve italiane.

**SHENIM:** aktualisht nuk lejohet mbajtja e dy nënshtetësive, nëse kërkohet ajo italiane për 10 vjet rezidencë, duhet të hiqni dorë nga nënshtetësia e mëparshme. (vetëm kush e merr për martesë mund t'i mbajë që të dyja).

# 5.

## PUNA

### 5.1 PUNËSIMI PËR ATA QË KANË DOKUMENTA TË RREGULLTA

Të huajve u lejohej hyrja në Itali për motiv punësimi si vartës (sezonal ose pa afat), për punë të pavarur (më vete) dhe për gjetje punë. Mund të ndërroni punësimin nga vartës në autonom pa qenë nevoja të informoni Kuesturën. Komunikimi bëhet vetëm në momentin e rinovimit të Lejes së Qëndrimit. Nuk është e mundur të punosh nëse L.Q. jepet për këto motive: turizëm, kërkesë për strehim politik, motiv e fetare, afarisëm, kura mjekësore, drejtësi.

### 5.2 PUNËSIMI PËR ATA QË VIJNË NGA JASHTË

#### PUNA SI VARTËS: AUTORIZIMI

#### KUSH?

Punëdhënsi, italian ose i huaj, në Itali.

#### PËR KË?

Qytetarin e huaj jashtë shtetit, i cili dëshiron të punojë në Itali..

#### SI MERRET?

- Punëdhënësi ,italian ose i huaj, që do të instauroj një raport pune me një të huaj banues jashtë shtetit, duhet të prezantoj në Sportelin e vetëm për imigracionin kompetent për territorin një kërkesë autorizuese me të dhënat personale të personit që don të punësojë;
- Dokumentimi i banesës për punëtorin e huaj;
- Proposta e kontratës së qëndrimit për punë si vartës, që përfshin impenjimin e punëdhënësit për pagimin e shpenzimeve të kthimit të të huajit në vendin e prejardhjes.
- Deklaratë impenjimi që të komunikoj çdo ndryshim në punë.

Drejtoria Provinciale e Punës vërteton që kushtet e punësimit ofruar nga punëdhënësi të mos jenë nën bazat e kontratave kolektive kombëtare o provinciale për kategorinë përkatëse. Kërkesa duhet të hyjë brënda limiteve të vendosura për kategorinë përkatëse të punësimit, sipas dekretit të fluksit vendosur nga qeveria italiane.

Kur merret autorizimi, duhet shpënë në Kuesturë për të kërkuar **nullaosta** (vertetim që nuk ka asnjë pengesë për të lëshuar vizën) me:

- një pull takse “marca da bollo” prej 10,33 €;
- fotokopjen e leternjoftimit të punëdhënësit;
- fotokopjen e pashaportës për të punësuarin.

Punëdhënësi dërgon autorizimin të punësuarit që ndodhet jashtë Italisë, i cili ka afat 6 muaj për të kërkuar vizën për “punë si vartës” tek ambasada italiane.

## KU?

- Sporteli i Vetëm për imigrantët kompetent për territorin Kuestura

## KUSH MUND TË JAPË NDIHMË?

- Coordinamento Immigrati CGIL/AGB, CISL/SGB, UIL/SGK

## REGJISTRIMI NË LISTAT E PAPUNËSISË

### KUSH?

Të huajt me dokumenta të rregullta, në bazë të ligjit D. Lgs. 286/98, kanë këtë të drejtë për të rritur mundësinë e punësimit e për gjetjen e në punë, të regjistrohen në listat e papunësisë. Sipas ligjit D.Lgs. 286/98 mund të regjistrohen këta persona:

- Ata që kanë një Leje Qëndrimi për punë si vartës dhe humbasin vëndin e punës, për periudhën e vlefshmërisë së Lejes së Qëndrimit e jo me pak se për një vit;
- Kush ka Kartën e Qëndrimit;
- Kush ka Leje Qëndrimi për familje;
- Kush ka Leje Qëndrimi për gjetje pune;
- Kush ka Leje Qëndrimi për mrojtje sociale;
- Kush ka Leje Qëndrimi për studime, sipas limiteve të vendosura nga dekreti vjetor për flukset.

### SI BËHET?

Për tu regjistruar në listat e papunësisë duhet të plotësohet një moduar, me të dhënat personale e profesionale të dokumentuara, pranë Zyrës për Punësimin Territorial (ex ufficio di collocamento).

### ÇFARË DOKUMENTASH DUHEN?

- Leja e Qëndrimit;
- Letërnjoftimi;
- Kodi fiskal;
- Çertifikatat për kualifikimin profesional e titujt e studimit marrë në Itali;
- Nuk është më e nevojshme paraqitja e Librezës së punës.

Kush transferohet në një qytet tjetër mund të transferojë dhe regjistrimin në listat e papunësisë, duke ruajtur të drejtën e mëparshme mbi kohën e kaluar në papunësi.

## KU?

Pranë **“Sezione Circoscrizionale për l’Impiego”**, në Bolzano Rruga L. Da Vinci 7.

## LIBREZA E PUNËS

### PËR KË?

Kush ka mbushur 16 vjeç dha ka Leje Qëndrimi e cila lejon punësimin. Nuk është më e nevojshme të dorëzohet menjëherë sapo fillon raporti i punësimit e megjithatë duhet regjistruar në librezë që nga data e fillimit.

**SI?****Për hyrjet e reja**

Kush vjen me vizë për punë, pasi bën kërkesën për lëshimin e Lejes së Qëndrimit në Kuesturë dhe fillon punë, mund të paraqiten tek **Inspektorati i Punës** për të kërkuar lëshimin e librezës së punës.

**CILAT DOKUMENTE DUHEN?**

- Autorizimi për punë dhënë nga "Direzione Provinciale del Lavoro" (origjinali dhe një kopje)
- Leja e Qëndrimit "L.Q.so di soggiorno"
- Fotokopiee pashaportës dhe e vizës
- Kopie e njoftimit të marrjes në punë bërëtek Zyra e Punës

Nëse dokumentat janë të plota Libreza mund t'i jepet dorazi menjëherë kërkuarit ose pundhësit.

Të huajt që kanë vizë për bashkim familje mund të fillojnë punë të rregullt dhe më pas u lëshohet Libreza e punës.(D.Lgs. 286/98 parashikon dhe regjistrimin në listat e papunësisë).

**Për të huajt rezident në Itali**

- Ata të cilët kanë Leje Qëndrimi **për studime** e frekuentojnë cikle shkollore, nëse duan të fillojnë një punë i lëshohet një Librezë pune për punë me orar të kufizuar (art.6 L. 943/86). Leja e Qëndrimit për studime mund të shndërrohet në punë sipas kuotave dhe kushteve të vendosura prej dekretit të flukseve.
- Kush ka Leje Qëndrimi **për gjetje punë** i jepet Libreza e punës në momentin kur fillon punë. Punëdhënësi plotëson kërkesën për Librezën duke paraqitur një kopje të Lejes së Qëndrimit bashkë me letrën e punësimit.
- Kush ka Leje Qëndrimi për **mbrojtje sociale**, librezë e punës i jepet kur punëdhënësi bën kërkesën.

**Kur mbaron raporti i punësimit** Libreza e punës i dorëzohet të punësuarit.

**Nëse humbisni Librezën** duhet të bëni denoncimin në polici dhe më pas të kërkonit duplikatën tek Inspektorati i Punës.

**NDIHMË LIGJORE PËR PROBLEME MBI PUNËSIMIN****KUSH?**

Ata që pushohen nga puna ose kanë probleme lidhur me pagesën, etj.

**KU?**

- CGIL/AGB
- CISL/SGB
- UIL/SGK

**ASISTENCË PËR PROBLEME SHËNDETSORE E SOCIALE****KUSH?**

Ata që kanë probleme lidhur me incidente gjatë punës, sëmundje, leje lindje, pushim nga puna

për falimentimin e firmës, invaliditet, pension, ndihmë ekonomike për gjëndje papunsie, etj.

## KU?

- PATRONATO i sidakatave INCA CGIL/AGB PATRONATO INAS CISL/SGB
- PATRONATO i sindakatave ITAL UIL/SGK

## 5.3 PUNË E PAVARUR - KOOPERATIVA

### KUSH?

Të gjithë ata që kanë dokumenta të rregullta e i lejohet të punojnë pa afat, mund të punojnë si të pa varur (me përjashtim të aktiviteteve që rezervohen vetëm për shtetasit italian). Është gjithashtu e mundur të ndërtohen shoqëri kapitalesh, pjesmarrja si aksionist ose ndërtimi i kooperativave. Mund të drejtoheni pranë Shoqërive të kategorive për sektore të ndryshme, për të marrë informacione të hollësishme.

### Çfarë duhet për të punuar si autonom:

- Shpesh kërkohet regjistrimi në Regjistrat e profesionit;
- Për disa aktivitete të keni dëshminë e aftësisë përkatëse;
- Për disa aktivitete duhen autorizime të ndryshme (A.S.L., Komuna, etj.);
- Në të gjitha rastet duhet të hapni një **partita IVA (numër për Taksën mbi Vlerën e Shtuar, T.V.SH.)**;

Regjistrimi në regjistrat profesional dhe hapja e partita IVA kanë njëfarë kostoje. Taksat paguhen në bazë të fitimit dhe gjithashtu duhet paguar sigurimi tek INPS-i e INAIL-i.

### KUSH MUND TU JAPË NDIHMË?

Këto shoqata: CNA • Confederazione Italiana Artigianato • Confesercenti • Lega delle Cooperative

## 5.4 INTEGRIME EKONOMIKE PËR NDIHMESË: ÇEKU FAMILIAR, PENSIONI, MARRJA E KONTRIBUTEVE TË PAGUARA NË RAST KTHIMI TË PËRHERSHËM NË ATDHE

### ÇEKU FAMILIAR

#### KUSH?

Kur të ardhurat familiare janë nën limitin e caktuar keni të drejtë për të marrë një ndihmesë ekonomike, e cila ju jepet, për personat në ngarkim, bashkë me rrogën mujore.

#### SI?

Plotësohet një modular kërkesë pranë INPS-it.

### KU PARAQITET KËRKESA?

I paraqitet:

- Punëdhënësit, me përjashtim të atyre që punojnë në sektorin bujqësor ose si shtëpiak;

- Tek qëndra e INPS-it, për të gjitha rastet.

## PENSIONI

### KUSH?

Të gjithë punonjësit si vartës në sektoret: industri, bujqësi e blegtori, artizanat, tregëti, shërbyes shtëpiak, etj. janë të siguruar me **detyrim** tek INPS-i kundër invaliditetit dhe për pensionin.

### SI?

Kategoritë e pensionit janë: për moshë pune, për moshë vjetërsie, pamundësi punësimi, çek invaliditeti.

### KU?

Duhet të paraqitet një kërkesë tek INPS-i, drejtpërdrejt ose nëpërmjet **patronatit** i cili jep asistencë gratis për punonjësit.

## KONTRIBUTET QË MERREN NË RAST LARGIMI NGA ITALIA

### KUSH?

Ata që largohen përgjithmonë nga Italia, mund të kërkojnë prarpsht kontributet e paguara tek INPS-i, të rritura me interesin prej 5% vjetore, me përjashtim të rasteve kur midis dy shteteve ka marrëdhënie të tjera.

### SI?

- Me anë të një kërkesë tek INPS-i;
- Duhet të dorëzohet Leja e Qëndrimit në kufi (bëhet një fotokopje me vulën e dorëzimit);
- Pika kufitare i paraqet Lejen e Qëndrimit të dorëzuar Kuesturës, e cila njofton INPS-in për daljen e përhershme nga territori e shtetasit të huaj;
- INPS-i më pas derdh shumën në një llogari bakare në emër të punonjësit të larguar, në vëndin e tijë.

### KU?

- Istituto Nazionale di Previdenza Sociale (INPS)

### KUSH MUND T'JU NDIHMOJË?

- Patronato INCA CGIL/AGB
- Coordinamento Immigrati CGIL/AGB
- Patronato INAS CISL/SGB
- Patronato ITAL UIL/SGK

# 6.

## ASISTENCA SHËNDETSORE

### 6.1 REGJISTRIMI NË SHËRBIMIN SHËNDETSOR NACIONAL

#### KUSH?

Regjistrimi në shërbimin shëndetsor nacional **(S.S.N.)** pranë Ndërrmarjes Shëndetsore Lokale (A.S.L.) të rezidencës, për vete dhe për familiarët nën ngarkim është **me detyrim dhe falas për të huajt që:**

- **Kanë Leje Qëndrimi** për punë dhe familje, azil politik, motive humanitare, kërkuesit e azilit, dhe ata që janë në pritje të adoptimit ose të tutelës, poashtu dhe personat në pritje të nënshtetësisë italiane.
- **Ata që janë të regjistruar në listat e papunsisë**, (regjistrohen me të njëjtat kushte të vendosura për shtetasit italian), ose në çdo mënyrë zhvillojnë aktivitete punë të rregullt, panvarsisht nga motivi i Lejes së Qëndrimit, i cili nuk parashikon regjistrimin me detyrin në Shërbimin Shëndetsor.

**SHENIM:** Regjistrimi në Shërbimin Shëndetsor Nacional është i vlefshëm vetëm përbrënda Italisë. Kurimet jashtë shtetit janë me pagesë.

Regjistrimi në A.S.L. është i vlefshëm gjatë gjithë afatgjatjes së Lejes së Qëndrimit. Nqs. Nuk keni **rezidence fikse** për efektin e regjistrimit vlen vëndi i shkruar tek Leja e Qëndrimit. Për punëtorët sezonal dhe me afat të përcaktuar regjistrimi bëhet në komunën ku lëshohet Leja e Qëndrimit.

Për ata të cilët kanë Leje Qëndrimi për kërkesë azili politik mjekimet janë pa pagesë (pa Ticket), duke marrë parasysh se këta nuk mund të punojnë.

#### KUSH KA TË DREJTË PËR ASISTENCË SHËNDETSORE?

Kanë të drejtë:

- **të huajt që janë në pritje të rinovimit të Lejes së Qëndrimit** për motivet: punë e pavarur ose si vartës, motiv familjar, azil politik, adoptim ose besimi nën përgjegjësinë e një kujdestari, marrje e nënshtetësisë, duke paraqitur L.Q. të rinovuar ose riçevutën për rinovim.
- **Të miturit (fëmijët nën 18)** menjëherë pas lindjes deri kur mbushin të tetëmbëdhjetat.
- **Familiarët**, me dokumenta të rregullta, në ngarkim të personit që punon rregullisht.

#### KUR SKADON SIGURIMI SHËNDETSOR?

Mbaron në rast se Kuestura i komunikon A.S.L.-it:

- Mos rinovimin e Lejes së Qëndrimit;
- Tërheqjen ose anulimin e Lejes së Qëndrimit
- Përrjashtimin nga territori

Me përjashtim të rastit kur i huaji bën apel në gjykatë kundër vendimit të administratës.

## KUSH NUK KA DETYRIM PËR TU REGJISTRUAR NË SHËRBIMIN SHËNDËTËSOR?

Ata që kanë L.Q. për biznes nuk kanë detyrim për tu regjistruar, ndërsa disa kategori të tjera punonjësish të huaj dhe familjarët e tyre nuk kanë detyrim për tu regjistruar në Shërbimin Shëndetsor Nacional (S.S.N.) por duhet të paguajnë një kuetancë sigurimi për rreziqe nga sëmundje, incidente, lindje. Këto kategori janë:

- Drejtues e specialist të shoqërive të cilat kanë qendrën në Itali , - me zyrat përfaqësuese të shteteve pjesmarrës në Organizatën Botërore për Tregëtinë, - qëndrat e shoqërive italiane ose shoqërive financiare të Bashkimit European.
- Punëtorë si vartës, punëdhënës rezident jashtë Italisë me transferim të përkohshëm për çështje punë.
- Gazetarët e gazetave, radio-televizjoneve të huaja.

Ata që kanë L.Q. të rregullt dhe nuk janë të siguruar në Shërbimin Shëndetsor duhet të paguajnë shërbimet sipas tarifave provinciale.

## REGJISTRIMI NË SHËRBIMIN SHËNDËTËSOR PËR ATA QË NUK JANË TË DETYRUAR KUSH?

I referohet atyre që kanë Leje Qëndrimi:

- me afatgjatje më teper se për 3 muaj për motive të tjera nga puna, ose lista papunësie, motive familiare, azil politik, gjëndje pritje për adoptim etj., paguajnë një kontribut vjetor për veten dhe për familjarët nën ngarkim. Ky kontribut llogaritet mbi përqindjen e të ardhurave për vitin e shkuar, ashtusi dhe për shtetasit italian.
- për studime nëpërmjet pagesës së një kontributi vjetor për ta dhe familjarët në ngarkim.

## TË HUAJT PA DOKUMENTA

Atyre të cilët nuk kanë dokumente të rregullta e janë pa të ardhura të mjaftushme u garantohet falas:

- mjekimet ambulatoriale urgjente për sëmundje dhe incidente, gjithashtu mjekimet preventi-ve;
- tutelë sociale dhe kujdes për gratë me barrë;
- kujdes për shëndetin e fëmijës;
- vaksinimi dhe ndërhyrje profilaktike kundra sëmundjeve ngjitëse.

“Stato di indigenza” do të thotë kur gjëndeni në pamundësi për të paguar kurat, atëherë duhet plotësuar një autodeklaratë, drejtuar Shërbimit Shëndetsor Nacional, për mos të paguar shpenzimet mjekësore.

Për mjekimin e të huajve pa dokumnteta, u jepet një kod rajonal identifikimi, i cili është i vlefshëm për mjekime në të gjitha qëndrat shëndetsore provinciale. Ky kod ka siglën S.T.P. (Straniero Temporaneamente Presente). Kodi i mësipërm u jepet nga ISTAT e strukturës shëndetsorë dhe përbëhet nga një numër rendor.

Kodi është i vlefshëm për të marrë receta medicinalesh nga mjeku, që blihen në më pas farma-ci.



**TAB. 1 REGJISTRIMI NË SHËRBIMIN SHËNDETSOR SIPAS LEJES SË QËNDRIMIT**

Leje qëndrimi për motiv	Regjistrim me detyrim	Regjistrim I lirë	Shënim
Punë si vartës	X		
Gjetje pune		X	
Regjistrim në listat e papunsisë	X		
Familje	X		
Studimi		X	Pagesë e një shumë forfe, pa përfshirë familjaret në ngarkim
Shëndetsore	X		
Kurime mjeksore			Paguhet me anë të një sigurimi privat

## MJEKU BAZË

### KUSH?

Kush është i regjistruar në Shërbimin Shëndetsor (me kartelë) ka të drejtë të zgjedhë mjekun bazë (i quajtur - mjeku familiar). Mjekut bazë i drejtoheni për vizita shëndetsore të përgjithshme në poliambulatorin e tij ,për të marrë receta medicinalesh ose për të prenotuar vizitat tek mjeku specialist. Mjeku bazë jep dhe raportet mjeksore (kur mungoni nga puna) për pundhënësin, gjithashtu bën vizita mjeksore shtëpiake kur nuk lëvizni dot ga shtrati.

### KU?

Mjekun bazë e zgjedhni në momentin kur bëni regjistrimin në Shërbimin Shëndetsor pranë sporteleve të A.S.L..

## 6.2 NËNA DHE FËMIJA

### PËR KE?

Grave shtatzanë i garantohet gratis të gjitha kurat mjeksore mbi shtatzaninë., edhe nëse nuk ka leje qëndrimi të rregull gja të periudhës së shtatzanisë gruaja gëzon këtë të drejtë dhe nuk mund të përjashtohet nga shteti Italian.

### KU?

**Consultorio Familiare** është vendi ku mund të kryheni të gjitha kongtrollet e nevojshme gjatë barrës dhe pas lindjes.

### SI?

Në muajt e parë të shtratzanisë është shumë e rëndësishme kryerja e disa analizave për shëndetin e nënës dhe të fëmisë.:bëhet fjalë për analiza shëndetsore.

## VAKSINIMI

### KUSH?

Për fëmijët që ndodhen në territorin italian është i nevojshëm vaksinimi kundra poliometilit, tetanozit, difterisë, dhe verdezës.

### KU?

Në ambulatorët mjeksor.

## 6.3 KOTRACEPTIMI

kontracetimi, janë metodat e ndryshme që përdoren për të mos mbetur me barrë.

### KU?

Informazione të plota për të gjitha mënyrat e kontracetimit i gjeni pranë Cnsulltorio Familiario

## 6.4 NDËRPRERJA E SHTATZANISË (ABORTIMI)

### KUSH?

Gruaja e cila don të ndërpresë shtatzaninë e pa dëshëruar mund të abortojë me kushtet që vijojnë:

- Nëse aborton në spital publik;
- Vetm gjatë 12 javëve të para pasi mbetet shtazanë.

### KU?

Mund të drejtoheni tek **Consultorio familiare**, ose në Spital për të marrë këshillimin e duhur mjeksor.

### SI?

Për të kryer abortin është e domozdoshme vizita mjeksor, në rastin më të mirë kryher pranë Consultorit familjar.

Për vajzat nën 18 vjeç kërkohet një leje ligjore tek Gjykata për fëmijët.

## 6.5 KËSHILLTORJA FAMILJARE PËR FËMIJË

Pranë ç' do Azienda Sanitaria Locale (A.S.L.) janë në funksion Konsultori familjar të cilët kanë për detyrë të japin asistencë gratis për gratë me barrë, edhe nëse ndodhen në Itali pa dokumenta, gjithashtu për fëmijët e saj nën moshën 18 vjeç.

Pranë Konsultorit ofrohen shërbime të ndryshme në mënyrë individuale ose kolektive:

- asistencë shëndetsore për nënën (asistencë ostetrike-gjinekologjike, kurse që përgatisin për lindjen dhe rritjen e fëmijës, etj.);
- asistencë grave që vendosin ndërprerjen e barrës me abortim në bazë të ligjit nr. 194/78;
- asistencë gjinekologjike për patollogji të ndryshme lidhur me sëmundjet seksuale;
- konsulencë për metodat kontracetive;
- kontrole dhe diagnoza për sëmundje tumorale të aparatit gjenital të femrës;
- konsulencë lidhur me probleme psikologjike, bashkshortore, raportin prind-fëmijë, shtatzanisë dhe seksualitetit.;
- ndërmjetësim familjar mbi probleme të ndryshme;
- asistencë për raste divorci, keqtrajtimi dhe dhune shtëpiake;
- informacione mbi adoptim dhe tutele mbi fëmijët;
- asistencë shëndetsore për fëmijët të cilët nuk janë të regjistruar në Shërbimin Shëndetsor;
- vaksinime;
- kontrollle prekonceptional.

Të gjithë shërbimet e lartpërmëndura janë gratis dhe mund të shfrytëzohen duke u paraqitur personalisht ose duke fiksuar vizitën me anë të një telefonate pa pasur nevojë për një kërkesë nga mjeku bazë.

## 6.6 RAJONET SHENDETSORE

Azienda Sanitaria Locale ndahet në Distretti Sanitari të cilat janë njësitë me të vogla në të cilat ndahet organizimi i shërbimit shëndetsor A.S.L.. Kanë për detyrë të garantojnë popullatës lokale kontrollin dhe kurën mjeksore bazë kolektive ose individuale.

Distretto sanitario është vendi ku kryhen disa kurime mjeksore ose infermjeristike. Distreto është vendi ku banorët drejtohen për të gjitha nevojat lidhur me shëndetin e për të marrë kontaktin e parë me shërbimin shëndetsore.

## ASISTENZA SOCIALE

Në Alto Adige kompetenca për të ofruar shërbime sociale i përket drejtpërdrejt **Provinces Autonome të Bolzanos** në bazë të statutit të autonomisë.

### 7.1 QËNDRAT E SHËRBIT SOCIAL

Në bazë të Ligjit Provincial n. 13 del 30 prill 1991 Provinca Autonome e Bolzanos i ka deleguar drejtimin e shërbimeve sociale Komunave të cilat orojne shërbimet nëpërmjet **Comunità Comprensoriali**, qendra për shërbime sociale të disa qendrave të banuara. Në qytetin e Bolzanos egziston Ndërrmarrja për Shërbimet Sociale që ofron këto shërbime (**Azienda Servizi Sociali di Bolzano (ASSB)**, Legge Provinciale n. 16 del 11.11.97.)

#### SHËRBITIMI SOCIAL NË BOLZANO (L'AZIENDA DEI SERVIZI SOCIALI DI BOLZANO)

Që prej 1 janarit të 1999 në qytetin e Bolzanos të gjitha shërbimet sociale drejtohen nga një organizëm i cili quhet Azienda Servizi Sociali di Bolzano (A.S.S.B.) e cila ashtu si Comunità Comprensoriali, kujdeset për mirqëniën dhe integritetin familjar të qytetarve në komunën e Bolzanos.

#### KUSH?

- Të rinjtë;
- familjet;
- të moshuarit;
- personat me handicap;
- personat me sëmundje psiqike;
- persona në vështirsi sociale.

#### SI?

- asistencë ekonomike (për personat me pak të ardhura);
- ndihmë shtëpiake;
- asistencë sociale;
- asistencë pedagogjike dhe edukuese;
- asistencë në vëndin e punës;
- çerdhe për fëmijët;
- "Tagesmütter";
- Konsultori familjar;
- Qendra kundër dhunës shtëpiake (centro di ascolto antiviolenza);
- Shtëpia e gruas;

- Sub Way – hapsirë për të rinjtë;
- shërbimi për të moshuarit “emergenza anziani”;
- qendra ditore për të moshuarit;
- mensë për pleqtë;
- kura klimatike për pleq ;
- azil për pleq dhe për të sëmurë;
- handicap e sëmundje psiqike;
- persona në vështirsi (prima accoglienza ai cittadini stranieri, campi nomadi për sinti e rom, servizi për tossicodipendenti, dormitori maschili e femminili).

## 7.2 DISTRIKTI SOCIO-SHËNDETSOR

### KUSH?

Është vëndi më i afërt ku qytetari mund të drejtohet për nevoja sociale ose shëndetsore të ndryshme

### SI?

Distrikti ofron:

- Informacion e konsulencë për shërbimet sociale e shëndetsore;
- Shërbime të ndryshme pranë distriktit të cilat mund të merren edhe në shtëpi ose në struktura të tjera.

shërbimet sociale– asistenciale të distrikteve janë këto:

- asistencë ekonomike;
- ndihmese shtëpiake;
- asistencë sociale;
- asistencë pedagogjike edukative;
- asistencë pranë vendit të punës;

## 7.3 SHËRBIMET E DISTRIKTIT

### ASISTENCË EKONOMIKE

#### KUSH?

Asistenca ekonomike i ofrohet familjeve ose personave të cilët ndodhen në vështirsi nga ana financiare duke u dhënë shuma të hollash.

#### SI?

Asistenca ekonomike ka të bëjë me:

- **Të ardhurat vjetore minimale** për të përballuar nevojat themelore të jetesës, si banesa, ushqimi etj.,
- Gjithashtu për të mos paguar **shpenzimet për kurat mjeksore**;

- **Shërbime të veçanta** për të përballuar rrethana në të cilat duhen bërë shpenzime të jashtëzakonshme në raste urgjente vetiake ose familjare.
- **Ndër të cilat:**
  - Përballimi i shpenzimeve për "telesoccorso";
  - kontribut për shpenzimet telefonike për të moshuarit;
  - kontribut për ata që ndodhen në situatë handicapi e kanë nevojë për mjete të përshtatshme;
  - pagesa e shpenzimeve përkatëse për tutelën e fëmijve nën 18 vjeç;
  - kontribut për asistencën mbi fëmijet deri në 3 vjeç ("Tagesmütter").

## **NDIHMESË SHTËPIAKE**

### **KUSH?**

Shërbimi mund të kërkohet nga persona që janë pjesërisht ose plotësisht të pa afte për të kujdesur vetveten nga pikpamja fizike e/ose mendore, jo më në gjendje të organizojnë jetën e tyre pa ndihmën e dikujt.

Ky shërbim ofron direkt pranë shtëpive të këtyre personave ose në qendrat në të cilat ndodhen për të ulur numrin e atyre që shtrohen në azilin e pleqve ose strukturat e asistencës.

### **KU?**

Tek distrikti socio – sanitar mund të merrni të gjitha informacionet e duhura dhe të bëni kërkesën për të shfrytëzuar këto shërbime.

## **ASISTENCË SOCIALE**

### **KUSH?**

Shërbimi i asistencës sociale, ndihmon qytetarët të cilët ndodhen vështirësi, duke kërkuar bashkë me ta për të dalë nga kjo situatë: shërbimi jepet nëpërmjet asistentëve social.

### **SHËRBIMET QË OFROHEN JANË:**

- asistencë e konsulencë sociale për familjet dhe personat për të zgjidhur problemet sociale.;
- informacion edhe ndihmë për t'u drejtuar strukturave që ofrojnë ndihmë për fëmijët dhe familjet;
- tutelë familiare dhe extrafamiljare për fëmijët, institute ose komunità alloggio.

Shërbimi është gratis.

## **ASISTENCË PEDAGOGJIKE DHE EDUKATIVE**

### **KUSH?**

Të gjithë qytetarët të cilët kanë nevojë për ndihmë e mbështetje lidhur me zhvillimin e personalitetit

### **SI?**

- Mikpritje dhe dëgjim i problemeve;
- Mbështetje në programet me karakter social;

- Mbështetje për familjet nëpërmjet konsulencës dhe bashkpunimit të shërbimeve publike dhe private;
- Grupe vullnetare të cilët ofrojnë ndihmë dhe mbështetje;
- Edukim shtëpiak.

Shërbimi kryhet nga edukatorët. Dhe është falas.

## **ASISTENCË PRANË VËNDIT TË PUNËS**

### **KUSH?**

Është një zyre provinciale e cila merret me projekte për gjetjen e punës në territorin e Provincës Autonome të Bolzanos, në bashkpunim me “Servizio di inserimento lavorativo della Provincia Autonoma di Bolzano”, I dedikohet personave të cilët kanë probleme psikike, sjelljeje, invaliditeti ose proble droge.

## 8.

## VËNDBANIMI DHE BANESA

## KUSH E SI?

Të huaj të cilët kanë Leje Qëndrimi të rregullt ose Kartë Qëndrimi dhe kërkojnë një banesë kanë tri alternativa:

- **blerjen**
- **marrjen me**
- kërkimin e një vëndstrehimi pranë **centro di accoglienza ose casa albergo**, të cilat janë banesa për beqarë të vëna në dispozicion nga Komuna dhe drejtohen nga shoqata të ndryshme.

## SHËNIM: BASHKIMI FAMILJAR

Për të bërë bashkim familje është e nevojshme banesa me sipërfaqe të kërkuar nga kriteret komunale; janë të nevojshme 38 m<sup>2</sup> për familje me dy persona dhe për ç'do person shtesë duhen 10m<sup>2</sup> më tepër.

## 8.1 BANESAT ME QERA

## KUSH E SI?

Për të gjetur një banesë me qera:

- Lexoni lajmërimet nëpër gazeta;
- Drejtoheni pranë një "agjenzia imobiliare".

Në çdo rast kur merrni një shtëpi me qera duhet të firmosni një kontratë qeraje e ta regjistroni tek Ufficio del Registro.

Normalisht kur firmoset kontrata, në pergjithsi si rregull, kërkohen si garanci parapagimi tre muaj qera nga ana e qeradhënësit. Këto para depozitohen në një librezë kursimi dhe i kthehen qeramarrësit në momentin kur del nga shtëpia.

Për ata që punojnë në sektorin e industrisë, kooperativa sociale **Temporary Home** ka lidhur një marrveshje me **Associazione Industriali** të provincës së Bolzanos për të gjetur sëbashku zgjidhje problemit të banesave për punonjësit e huaj.

## 8.2 BANESAT SOCIALE

Janë banesat që jepen nga IPES (Istituto Per l'Edilizia Sociale), duke patur si kusht të pakten **5 vjet rezidencë ose punësim** në provincën e Bolzanos.

IPES, jep banesat që ka në dispozicion me anë të një liste (me shumë pikësh) për ata të cilët kanë bërë kërkesë.

Lista afishohet tek zyrat e IPES-it duke treguar shumën e pikëve të mbledhura nga kërkuesit.

Në qofte se doni **të kundërshtoni** rrezultatit e pikëve që ju kanë dhënë duhet të paraqisni një



kërkesë (ricorso) 30 ditë brënda njoftimit të pikve. Kundërshtimet miratohen nga një Komision i caktuar brënda 60 ditve.

Lista perfundimtare afishohet publikisht.

Bashkë me kërkesën për banesën IPES duhet të paraqisni edhe:

- kopjen e Lejes ose të Kartës së Qëndrimit;
- deklaratë nga pundhënsi;
- kopjen e deklaratës mbi të ardhurat e vitit të kaluar [Legge provinciale n. 13 del 17.12.1998 art. 99].

**SHENIM:** kërkesa për banesat e IPES-it paraqiten çdo vit gjatë majve shtator-tetor.

Mund të kërkonit informacion tek Uffici di Edilizia Abitativa të Komunës së rezidencës; përgjithsisht kushtet janë të njëjta me ata që bëjnë kërkesën pranë IPES-it.

### 8.3 NDIHME EKONOMIKE PËR PAGESËN E QERASË

Mund ta kërkojnë ata që kanë një kontratë qeraje të rregullt.

Kërkesa bëhet tek IPES ose Komunës së rezidencës, duke paraqitur këto dokumente:

- fotokopjem e L.Q. ose K.Q.;
- fotokopjen e letërnjoftimit;
- fotokopjen e kontratës së qerasë të regjistruar, ashtu edhe pagesën e taksës për regjistrimin e kontratës;
- deklaratën mbi të ardhurat e vitit të shkuar;
- liçencën e banueshmërisë të lëshuar nga Komuna [l'Ufficio tecnico del Comune];
- pagesat muajve të fundit (të qerasë);
- planimetrinë e banesës (Ufficio Tavolare del Comune);
- certifikatë për "alloggio non convenzionato" (kontratat e regjistruara para dates 08.1999), kërkohet tek Ufficio Tavolare del Comune ose me ane të autodeklaratës së padronit të shtëpisë;
- pull takse "marca da bollo" prej 10,33 €;
- vendimin e gjykates për ndarje ose divorc nëse jeni të ndarë nga bashkëshorti.

**SHËNIM:** për të bërë kërkesë ndihme ekonomike për pagesën e qerasë nuk janë më të nevojshëm 5 vjet rezidencë ose punësim në provincën e Bolzanos, mjafton kontrata e rregullt.

### 8.4 QENDRAT PËR BANIM TË PËRKOHSHEM - CASE ALBERGO

Qytetarët e huaj që janë të paisur me dokumenta të rregullta dhe janë në kërkim pune mund të drejtohen tek **Centri di prima accoglienza** për banim të përkohshëm deri në gjetjen e një pune dhe kur janë të punësuar mund të bëjnë kërkesë për një dhomë pranë një "**casa albergo per lavoratori**".

**Centri di prima accoglienza** janë qendra në të cilat gjejne strehim provizor personat që ndodhen në një situatë të vështirë. Për të pasur mundesine e një strehimi të interesuarit duhet të bëjnë një kërkesë të "Ufficio prima accoglienza immigrati dell'**ASSB**" që drejtohet nga **O.D.A.R**

- **Caritas.** Qëndra është e hapur për të gjithë të huajt mbi 18 vjeç dhe pa punësim. Afati i strehimit është maksimumi 30 ditë/nate (edhe të ndara njëra nga tjetra për tri here rradhazi) dhe orari i hyrjes është nga ora 19.00 deri në ora 22.00, dalja nga ora 7.00 deri në 8.30, nuk lejohet qëndrimi gjatë dites.

### DOKUMENTAT PËR TË BËRË KËRKESË:

- L.Q. ose K.Q.
  - Libreza e punës për të provuar gjëndjen e papunësisë
  - Çertifikate shendetsore për të ndenjur në komunitet e leshuar nga A.S.L..
- Sapo gjeni një punë mund të bëni kërkesë tek “Casa del Giovane lavoratore” për banim për një periudhë 6 muaj max. duke u prenotuar të **“Ufficio dell’ASSB: Servizio a Persone in Situazione di Disagio”** **Ruga Claudia Augusta 45** duhet të keni me vete L.Q. dhe deklaraten e punësimit .
- “Case albergo për laborator”** janë qëndra për strehim me afat të gjatë dhe drejtohen nga **IPES** ose shoqata private që kanë me të marrveshje. Për të patur mundësi strehimi në to duhet të bëni kërkesë të IPES duke paraqitur L.Q., deklaraten e punësimit dhe atë për të ardhurat vjetore.

**SHENIM:** nuk janë të nevojshme 5 vjet rezidence për të pasur të drejtën e banimit në “Case albergo”.

## 8.5 BLERJA E SHTËPISË

Për të marrë ndihmë ekonomike nga Provinca për blerjen e shtëpise të interesuarit duhet të plotesojnë **kushtet** e mëposhtme:

- të jenë rezident ose të punësuar prej 5 vjetësh në provincën e Bolzanos;
- mos të jeni pronar ose me të drejtë “usufrutto” mbi një banesë;
- mos jeni pjestar të një familje e cila gëzon të drejtën për kontribute ekonomike publike mbi blerje ose ndërtim e një banese; me perjashtim të rastit kur formohet një familje e re (2 kurora);
- të ardhurat vjetore të mos tejkalojnë maksimalin e vendosur nga ligji (art. 58 dalla L.P. n. 13/’98).

Kush është i interesuar për blerjen e një banese mund të drejtohet pranë agjensive për shitje banesash për tu informuar ose dhe me ane të shqyrtimit të gazetave.

Për të marrë një **mutuo** (kredi nga banka ose institute të tjera që japin hua) mund të drejtoheni pranë bankave për informacione.

Nëse keni pak të ardhura vjetore është e mundur që të kërkonti kredi me interes të ulët nga Provinca e Bolzanos duke paraqitur një kërkesë tek zyra **“Ufficio Promozione Edilizia Abitativa”**: Mund të marrin këto kredi vetëm personat që kanë mbushur 23 vjeç.

# 9.

## SHKOLLA DHE UNIVERSITETI

**Shkolla** u jep mundësi të rinjve për të rritur intelektin dhe të përgatiten për një profesion.

**Shkollimi i të rriturve** u drejtohet personave që dëshirojnë të marrin ose të thellojnë përgatitjen profesionale jashtë ciklit të studimeve shkollore. Bëhet fjalë për kurse specializimi të tipit praktik me afat të percaktuar që shpesh herë përfshijnë dhe një periudhë stazhi.

### 9.1 REGJISTRIMI SHKOLLOR

Ligi i Shtetit italian mbi shkollimin detyron frekuentimin e ciklit shkollor nga 6 deri në 16 vjeç.

Të gjithë fëmijët duhet të frekuentojnë shkollën me detyrim edhe nëse nuk kanë Leje Qëndrimi të rregullt. Për regjistrimin mjafton **çertifikata e vaksinimit** dhe **çertifikata mjeksore**. Në provincën e Bolzanos kemi tri modele shkollash në bazë të gjuhës se folur: gjermane, italyane dhe ladine.

#### SI?

**Regjistrimi shkollor** mund të bëhet në çdo periudhë të vitit shkollor.

- Fëmijët që ndodhen në Itali kanë të drejtën e shkollimit edhe nëse nuk kanë dokumente të rregullta.
- Regjistrimi në shkollë bëhet sipas moshës duke futur fëmijën në klasën perkatese, me përjashtim të rastit kur Keshilli i Mësuesve vendos regjistrimin një vit para ose pas moshës perkatese (në baze të aftësive dhe zhvillimit).
- Për njohje sa më të shpejtë të gjuhës gjermane ose italyane mund të organizohen nga ana e shkolles kurse intensive.
- Për ndihmë dhe komunikim mes shkolles, fëmijës dhe familjen, mund të përdoren Ndërmjetsit Gjuhësor (mediatori interculturali qualificati).
- Shkolla gjithashtu bashkëpunojnë me shoqata të ndryshme për projekte kulturele dhe integrimi për nxënësit.

### 9.2 ÇERDHJA PËR FËMIJËT

Në Provincën e Bolzanos vetëm Komuna e Bolzanos dhe Meranos kanë çerdhe për fëmijët.

Mund të regjistrohen nga muaji i 3-të deri në 3 vjeç. Kërkesa bëhet në muajin Prill ose Tetor të çdo viti (edhe menjehere pas lindje se fëmijës). Frekuentimi nuk është me detyrim por kur fëmija mungon për kohë të gjatë humb të drejtën e vëndit. Shërbimi është me pagesë. Orari zgjat nga ora 7.30 deri në 17.00.

### 9.3 KOPSHTI PËR FËMIJËT

Mund të regjistrohen fëmijët nga moshë 3 deri në 5 vjeç. Kopshtet për fëmijë mund të jenë shtetërore ose private. Për të regjistruar fëmijën në Kopshtin shtetëror (zakonisht në atë me afer banesës) bëhet gjatë muajve Janar-Shkurt. Orari zgjat përgjithësisht nga ora 7.45 me daljen e

pare të femijve në ora 12.15, e dyta në orën 14.15, dhe e fundit në orën 17. frekuentimi nuk është me detyrim dhe shërbimi është me pagesë.

### SHKOLLA ME DETYRIM CIKLI I ULET (ELEMENTARE- MEDIE)

Shkolla fillon në shtator dhe mbaron në qershor (një vit shkollor). Regjistrimi dhe frekuentimi i shkolles është falas dhe me detyrim. Regjistrimi mund të bëhet në çfaredolloj periudhe të vitit shkollor. Për fëmijët që vijnë dhe kanë filluar ciklin shkollor në një vend tjetër vendos shkolla në cilën klasë t'i regjistrojë. Regjistrimi bëhet duke paraqitur kërkesën pranë shkolles ku deshiron (zakonisht asaj me pranë banesës) gjatë muajit janar për ata që bwejne regjistrimin në klasen e parve fillore.

Kalon vitin shkollor në rast kur nxwenwesi kalon klaswen me vleresim pozitiv nga ana e mesuesve mbi mbarvajtjen shkollore. Nëse vlerwesimi në disa lëndë është negativ atëherë nxënësi perserit klasen. Një nder lendet që mesohet në shkollë është Religione (Edukim fetar), për të cilën mund të bëhet kërkesë që fëmija mos të marri pjese në oret e Edukimit fetar nëse nuk ehste dakort familja. Në fund dhe në mes të vitit nxenesit marrin deftesat me vleresimin me shkruim që u bëhet nga ana e mesuesve të të gjitha lëndëve. Prindi firmos deftesen e cila i kthehet shkolles. Zakonisht femijve u jepen detura shtëpie për të perforcuar nocionet e mesuara në shkollë. Librat merren hua nga shkolla dhe mbahen me kujdes për gjatë gjithë vitit në fund dorezohen për tu perdorur nga nxenesit e tjere. Dy here në vit behen takime prinder-mesues (udienze generali). Çdo mesues/e vendos një ditë të javes me një orar të caktuar për tu takuar veçanerisht me prindrit e nxensve (udienza singola) për mprobleme lidhur me mbarvajtjen shkollore. Prinderit e nxenesve emerojne mes tyre një perfaqesues për klasen për të ndihmuar mardheniet shkolle-prinder. Mungesat, ardhja me vonese ose dalja para kohë duhe justifikohen nga prindi tek blloku i komunikimeve që u jepet nxenesve. Në rast semundjeje e cila zgjat me teper se 5 ditë mungesa nga shkolla nuk mjafton vetëm justifikimi i prindit por duhet një raport mjeksor.

Shkolla mund të vije ndesh nxenesve për ti ndihmuar me ane të Ndermjetsit Kultural (Mediatore interculturale) për të kuptuar dhe mesuar gjuhen.

Nëse gjendet mundesia mund ta regjistroni fëmijën në orarin e zgjatur deri në ora 16<sup>00</sup> (tempo pieno).pervec mesimit normal shumë shkolla organizojne edhe aktivitete jashteshkollore ose eskursione me qellim didaktik, aktivitete pergjithesisht me pagese. Fëmijët në shkollë mund të shfrytezojne edhe mensën duke blere bonot pranë Komunes se rezidences. Gjithashtu për nxenesit e huaj në orare jashteshkollore zhvillohen aktivitete të veçanta. si ato që organizohen në Bolzano nga drejtorite e disa shkollave në bashkpunim me organizata e shoqata të ndryshme. "L'Istituto pedagogico in lingua italiana" ka botuar një udhezues për organizimin shkollor për nxenesit e huaj e cila mund të kerkohet të Rruga del Ronco n.2, tel. 0471-411453

## 9.4 SHKOLLA ELEMENTARE

### KUSH?

Për të gjithë fëmijët që kane mbushur 6 vjeç.

### SI?

Shkolla elementare zgjat 5 vjet. Në fund të vitit të peste bëhet një provim i thjeshtë për të leshuar licencën elementare me të cilin bëhet regjistrimi në ciklin shkollor që vijon e quhet shkolla

e mesme e ulet “scuola media inferiore” (korrespondon klases se gjashte deri tek klasa e tete e regjimit shkollor në Shqipëri).

## 9.5 SHKOLLA E MESME E ULET

### KUSH?

Për të gjithë fëmijët që kane kaluar provimin e klases se peste në shkollen elementare ose që kane je deftese perkatëse leshuar nga një shkollë në një vend tjetër (deftesen e perfundimit të klases se peste në Shqipëri) dhe kane mbushur 11 vjeç. Normalisht nxenesit mbarojen shkollen e mesme të ulet kur kane mbushur 14 vjeç. Frekuentimi i një cikli shkollor është me detyrim deri në moshën 16 vjeç.

### SI?

Shkolla e mesme e ulet zgjat tre vjet. Në fund zhvillohet një provim me të cilin leshohet licënza e sholles se mesme e ciklit të ulet me të cilin kryhet regjistrimi në shkollen e mesme të ciklit të larte.

## 9.6 SHKOLLA E MESME E CIKLIT TË LARTE:

Regjistrimi bëhet vetëm për ata që kane dehmine e shkolles se mesme të ulet, dmth. nga 14 vjeç e lart. Janë shkolla të ciklit të larte Liceu (classico, scientifico, linguistico, artistico), shkolla teknike (për ragonieri, geometri, periti industrial), shkolla profesionale (settore commerciale e turistico, settore industria e artigianato), shkolla pedagogjike. Shkolla e mesme e ciklit të larte zgjat 5 vjet (klasa 9-të klasa e13-të). Në fund të shkolles bëhet provimi i shtetit me të cilin leshohen diplomat e me pas është i mundur regjistrimi në universitet ose në kurse specializimi “post-diploma”.

## 9.7 UNIVERSITETI

Hapun në Bolzano që prej vitit 1997, ka kurse studimi në deget ekonomi “laurea in economia e management”, “management del turismo”, “tecnica ed economia agraria”, “ingegneria logistica e della produzione” poashtu kurse studimi në Fakultetin e shkencave dhe atë të shkencave teknologjike e informatike.

### SHKOLLA PRIVATE:

Ka disa lloje shkollash private duke perfshire gjithashtu kopshte, çerdhe e disa shkolla elementare dhe të mesme të ulta në Bolzano. Disa prej shkollave private organizojne kurse për leshimin e diplomës se pjekurise.

## 9.8 SHKOLLIMI I TË RRITURVE

Për të rriturit që nuk kane deshmi për shkollen me detyrim organizohen kurse në mbremje për opunonjes që quhen “150 orë”. Jepet mundësia për ata që ndjekin këtë shkollë të kene dhe lehtesime nga punë. Zgjatje e ketyre kurseve është një vit shkollorë. Për informacion drejtohuni tek scuola media Leonardo da Vinci.

Në Bolzano dhe qytetet e tjera të Provinces organizohen **kurse gjuhe për të ghuajt**.mund të infomoheni pranë **scuola media Dante Alighieri** ose **qendrave private të formacionit** të specia-

lizuare në gjuhe ( Bolzano, in via Piave 3), **Fondo Sociale Europeo FSE** organizon të gjithë kurset me ndihmen e Bashkimit Evropjan për specializime në fusha të ndryshme.

## 9.9 NJOHJA E STUDIMEVE TË BËRA JASHTË

Njohja e studimeve për regjistrimin në universitet është kompetence e universiteteve në veçanti të cilat kane autonomi të plote dhe vendosin në baze të kriterëve të ndryshme të vendosura në rregulloren e tyre të brendshme ose marrveshjet me jashte.

## 9.10 NJOHJA E PROFESINEVE

Qytetaret e huaj të paisur me dokumenta të rregullta që kane **një kualifikim profesional** marre në një vend i cili nuk i perket Komunitetit Evropjan të cilët desheroje të ushtrojne zanatin e tyre mund të regjistrohen në institutet kompetente për profesionetdhe të kerkojne **njohjen e kategorise** se zanatit. Kërkesa i paraqitet **Ministrise perkatese** me të dhenat e kerkuara. Brenda 30 ditve Ministria kthen pergjigje e verifikimit të kategorise se profesionit, duke shtjelluar kushtet që duhen plotesuar.

## 9.11 VEÇANTIA E PROFESIONEVE SANITARE

regjistrimi i qytetarve të huaj në listat që i perkasin profesiveve shendetsore bëhet në lista speciale. Kusht paraprak për regjistrimin është njohja e gjuhes italiane dhe të normave e ligjeve që vendosin rregullat për ushtrimin e **profesionit në fushen e shendetsise**. Rregullat vendosen nga **Ministria e shendetsise** italiane e cila ka kompetencen për të njohur **titullin e studive pse kualifikimin profesional** marre jashte vendeve të Bashkimit Evropjan dhe provimet që duhen bërë për njohjen e ketyre titujve. Gjithashtu parashikohen kuota për hyrjen në Itali për ata që duan të ushtrojne profesione sanitare me dkret ngaPresidenti i Keshillit të ministrave italian.

# 10.

## SHKOLLAT PËR PROFESIONE “FORMAZIONE PROFESSIONALE”

Formacioni profesional në provincën e Bolzanos merret me formimin baze të rinjve për azhurnimin dhe përgatitjen në profesione të ndryshme. Provinca autonome e Bolzanos ka shkollë profesionale në gjuhën italiane dhe gjermane.

Në të dyja shkollat janë disponibel shërbime orientimi “**Servizi di Orientamento professionale**”, që japin të dhëna mbi mundësitë e përgatitjes dhe gjetjes së punës.

### SI?

Nepermjet bashkpunimit të ngushtë me firma të ndryshme në territorin e Bolzanos “Formazione professionale” ofron mundësi për të zhvilluar kompetencat e nevojshme për gjetjen e një pune sa me të mirë me plotësimin e kushteve të përgatitjes profesionale individuale.

Llojet e përgatitjes profesionale janë tre:

- Me kohë të plote “formazione a tempo pieno”;
- Si çirak “l’apprendistato”;
- Formin i vazhdueshëm “formazione continua”.

### KU?

Këto përgatitje ofrohen nga Formazione Professionale Italiana dhe Formazione Professionale Tedesca e Ladina.

## 10.1 LLOJET E FORMIMIT

### ME KOHË TË PLOTE

#### KUSH?

Këto kurse i drejtohen atyre që kanë kryer shkollën e mesme të ciklit të ulët ose kanë një diplomë shtetërore ose një kualifikim profesional.

#### SI?

Kurset projektohen dhe zhvillohen duke patur parasysh nevojat e tregut të punës për të lehtësuar punësimin e mepasshëm duke marrë gjithashtu parasysh sektore të ndryshme (agrarior, alberg-hiero, commercio e servizi, industria e artigianato, delle professioni sociali).

#### KU?

Këto përgatitje ofrohen nga Formazione Professionale Italiana dhe Formazione Professionale Tedesca e Ladina.

### APPRENDISTATO

Disa kontrata lejojnë shkollën me shkeputje nga puna, zakonisht për të rinjtë që marrin një zanat, duke njerëz përgatitjen mesimore pranë shkollës profesionale në një pjesë të orarit të punës.

**KUSH?**

Zakoisht zgjat 3 ose 5 vjet me ane tre kesaj metode leshohet një deshmi aftesie që verteton kompetencen për të ushtruar një profesion. Mund të marrin pjese të rinjte të cilët kane kryer detyrimin shkollor dhe janë nen moshen 25 vjeç, në disa raste të veçanta mosha zgjatet deri në 29 vjeç.

**SI?**

Është një lloj kontrate punë ku parashikohet bashkpunimi i pundhensit me shkollen profesionale për formimin e punetorit në një zanat duke marre dhe pagese për oret e puens praktike dhe oret shkollore.

**KU?**

Këto pergatitje ofrohen nga Formazione Professionale Italiana dhe Formazione Professionale Tedesca e Ladina dhe “Ufficio Apprendistato”.

**FORMIMI PROFESIONAL I VAZHDUESHEM****KUSH?**

U drejtohet personave të rritur të punesuar ose në kerkim të një punë.

**SI?**

Parashikohet këto lloj aktivitetesh:

- Që i drejtohen punonjesit i cili do të rrise pergatitjen e tij profesionale me ane të kurseve;
- Aktivitete në lidhje me firmat të cilat kane nevojë për azhornimin e punonjsve me teknologjite inovative.

**KU?**

Këto aktivitete organizohen nga “**Servizio Formazione continua sul lavoro**” Formazione Professionale Italiana dhe Formazione Professionale Tedesca e Ladina.

**10.2 SHËRBIMI I KONSULENCES MBI FORMIMIN PROFESIONAL****KUSH?**

Ky shërbim i ofron të rinjve keshilla të dobishme për zgjedhjen e kurseve të pershtatshme në lidhje me të ardhmen e tyre në boten e punës. Edhe ata që ndeshin në vështirsi për gjetjen e një punë ose të një punesimi me të mire, mund t?i drejtohen ketij shërbimi për të marre informacionet e nevojshme.

Shërbimi është falas.

**SI?**

Konsulenca bëhet me ane të takimeve me operatoret e shërbimit të cilat synojne në vleresimin e mundesive dhe kapacitetit profesional vetiak.

**KU?**

Këto shërbim ofrohet nga Formazione Professionale Italiana dhe Formazione Professionale Tedesca e Ladina.



# 11.

## MBROJTJA E TË DREJTAVE

### 11.1 E DREJTA E MBROJTJES DHE 11.2 GRATUITO PATROCINIO

#### KUSH?

Qytetarve të huaj i garantohet të drejta të barabarta me qytetarin italian për të drejten e mbrojtjes gjyqësore.

#### SI?

Qytetarët e huaj të pandehur që nuk kanë të ardhura dhe nuk mund të paguajnë një avokat mbrojtës kanë të drejten e avokatit gratis, paguar nga Shteti italian e cila quhet “**gratuito patrocinio**”.

gratuito patrocinio mund të kërkojë në të tilla raste:

- proces penal;
- gjatë shlyerjes së denimit;
- në proceset penale kundër të miturve (nën 18 vjeç);
- në proceset lidhur me “Tribunale di Sorveglianza”.

#### KU?

Kërkesa për avokatin e paguar nga shteti bëhet me shkrim dhe depozitohet pranë kacearit të gjykatës (leter raccomandata) i cili ndjek procesin gjyqësor.

### 11.3 MBROJTESI QYTETAR “DIFENSORE CIVICO”

#### KUSH?

Difensore civico është një figurë në dispozicion të të gjithë qytetarve të cilët kanë nevojë për mbrojtje falas kundër administratës publike.

#### SI?

Difensore civico mban rolin e garantit me detyrën e senjalizimit të ç’faredolloj shkelje dhe abuzimi ose keqfunksionim të aparatit shtetror në rraport me qytetarët.

### 11.4. NORMA LIGJORE PËR FËMIJËT

Fëmijët e atyre që kanë Leje Qendrimi të rregullt në Itali **regjistrohen në L.Q.** e të dy prindërve ose të njerit deri sa mbush 14 vjeç dhe ndjek kushtet e prindit me të cilin bashkëton, ose shfrytëzon kushtet me të favorshme për bashkëjetesën kur prinderit janë të ndarë. Deri në moshën 14 vjeç fëmija rrezulton **nen tutelen dhe përgjegjësinë** e plotë të prindit [art. 4, legge 4.05.1983, n. 184].

Mungesa e perkohshme nga territori i Shtetit italian nuk përjashton kushtin e bashkëjetesës së fëmijës me prindin.

Kur fëmija mbush moshën 14 i leshohet një Leje Qendrimi personale për motive familjare ose

K.Q. , me vlefshmeri deri në mbushjen e moshes 18 vjeçare. Gjykata për të miturit në lidhje me fakte të rënda mbi zhvillimin psiko-fizik të fëmijësi cili ndodhet në territorin italian, duke marrë parasysh disa arsye lidhur me moshën, kushtet shëndetsore etj mund të autorizojë ardhjen e prindit për një periudhë të caktuar pa marrë parasysh procedurën normale të vendosur me ligj për hyrjen në territorin e shtetit italian. Autorizimi mbaron se qenuri kur nuk egzistojnë me të tilla vështirësi lidhur me zhvillimin e fëmijës. Këto vendime i komunikohen përfaqësues diplomatike italiane dhe kuestorit për kompetencat perkatëse.

### **PERJASHTIMI NGA SHTETI I NJË FËMIJË**

Kur vendoset perjashtimi nga shteti për fëmijët mund ta japë në baze të kërkesës së Kuestorit vetëm Gjykata për fëmijët “Tribunale për i minorenni”.

## **11.5 MASA KUNDËR DISKRIMINIMIT RRACIAL**

Ligji për imigracionin parashikon disa masa kundër akteve diskriminuese raciale dhe intolerante kundrejt të huajve.

### **KUSH?**

Janë masa për ndershkimin e atyre personave të cilët kryejnë akte diskriminimi për motive race, ngjyre, ose etnike, fetare e nacionale dhe ve në rrezik të drejtat njerzore në çdo sektor të jetës publike.

### **KUNDËR KUJT?**

Këto masa janë kundër:

- Pubblico ufficiale, dmth personit që ka një funksion publik në administratën shtetërore dhe gjatë kryerjes së detyrës kryhen ose nuk kryhen veprime të tilla të cilat diskriminojnë padrejtesisht qytetarin e huaj;
- Cilido që vendos kushte të pabarabarta ose refuzon dhenien e një shërbimi publik një qytetarit të huaj;
- Cilido që vendos kushte të pabarabarta ose refuzon dhenien ose shfrytëzimin e banesave, punesimit, shkollimit, shërbimeve sociale për të huajt që janë paisur me dokumenta të rregullta vetëm me pretekstin se janë të huaj;
- Cilido pengon zhvillimin e aktiviteteve ekonomike ligjeshme të lejuara për të huajt;
- Cilido ben akte diskriminimi raciale në vendin e punës mbi një të huaj;
- Ata që kanë sjellje ksenofobe dhe raciste.

### **SI dhe KU?**

Denoncimi bëhet me shkrim pranë kancelarit të gjyqkatesit në Gjykatën e përgjithshme “Tribunale ordinario” të vendit të banesës.

# 12.

## KULTURA DHE BASHKPUNIMI INTERETNIK

### 12.1 QENDRA PËR ZHVILLIMIN KULTUROR DHE 12.2 BASHKJETESA INTERETNIKE

#### KUSH?

Qytetaret e huaj të cilët ndodhen në territorin e “Provincia autonoma di Bolzano” mund të shfrytëzojnë shërbimet e ofruara nga qendrat për zhvillimin ekultures dhe mesimin e gjuheve.

#### SI?

Këto institute nderhyjne pranë moshave të reja me aktivitete jashteshkollore në sektorin e edukimit kulturor dhe shkencor.

#### KU?

Mesimi i gjuheve është kompetence e “**Ufficio Bilinguismo e lingue straniere**”, për për zyrat e kultures italiane, ndersa për ato gjermane “**Ufficio Educazione Permanente**”.

Këto zyra organizojne kurse me pagese në fushen e kultures, gjuhes, informatikes e shumë fusha të tjera.

### 12.3 BASHKEPUNIMI PËR ZHVILLIM

#### KUSH?

Si “Provincia Autonoma di Bolzano” ashtu dhe Komuna e Bolzanos vene në dispozicion për vetiakët ose organizatat që kane qender në provincen e Bolzanos të ardhura financiare dhe forca njerzore në favor të zhvillimit të aktiviteteve për bashkpunim me vendet e varfera për paqen dhe solidaritetin nderkombetar.

#### SI?

Ata që janë të interesuar duhet të paraqisin një kërkesë me ane të një modulari pranë Entit në të cilin kerkojne financime ekonomike për projekte zhvillimi.

#### KU?

Zyra kompetente për dhenien e kontributeve në province është “**Ufficio Affari di gabinetto – Servizio cooperazione allo sviluppo della Provincia Autonoma di Bolzano**”, për Komunën është “**Ufficio di Pianificazione Sociale**”.

